

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ONEST" SHPK

Ne Durres sot me daten 31 Janar 2022 , mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare" , ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR" **ortaku I vetem I shoqerise Z. Alvin Shehu** banues ne Durres, me vullnet te lire e te plote vendi te krijoje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **"ONEST" SH.P.K** , per kete qellim hartohet Akti i Themelimi i Shoqerise me keto kushte:

NENI 1

Ne kuptimin e ketij Akti Themelimi ortaku i vetem i kesaj shoqerie eshte:

1. **Alvin Shehu**, i biri i Astritit dhe Aferdites, i datelindjes 27.05.1980, lindur ne Durres, dhe banues ne Durres, Shqiperi, me pasaporte nr. BB9377574 dhe nr.personal I00527074J.

I cili eshte themelues i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **"ONEST" SH.P.K**, me seli ne : Lagjja nr.4, Rruga Fetah Bllaca, me nr.pasurie 2/238/ND, zona kadastrale 8514, Durres

NENI 2

Veprimtaria e shoqerise , mardheniet e saj me persona te trete fizike e juridike, vendas e te huaj , private e shteterore , rregullohen ne baze te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare" , te akteve , te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij ligji si dhe ne statutin e akt-themelimin e shoqerise.

NENI 3

Per detyrimet e veta Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarise , emertimi , selia e shoqerise , shtimi i ortakeve dhe ato cka jane percaktuar ne statut mund te ndryshojne me vendim te asamblese se pergjithshme dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 5

Objekti i Veprimtarise se Shoqerise se **"ONEST" SH.P.K.**, eshte si vijon:

Al

Import-eksport, tregetim dhe punime materiale te ndryshme elektrike, hidraulike, bojra te ndryshme, punime druri, punime alumini, hekuri, punime murature, kartonxhesi, shitje materiale kancelerie dhe materiale per zyra. Tregetim te veglave te punes dhe veshjeve te punes, uniforma speciale etj. Tregetim te farave dhe fidaneve, peme dekorative etj. Tregetim mobiljesh, artikujve industriale dhe produkteve per arredim. Pjese kembimi, automjete.

Punime ne sistemin e informatikes.IT-ja. Printim, zarfim, tregetim te vajrave ushqimore dhe industriale, pajisje laboratorike REAGEN. Tregetim, riparim, montim te impianteve, kondicionereve, aspiratoreve. Transport i brendeshem dhe i jashtem per vete dhe per te trete etj.Tregetim te materialeve te pastrimit higjenik dhe kimik,detergjent etj.Punime ne fushen e ndertimit ne rruge, cerdhe, kopshte, shkolla, ndertesa civile dhe industriale, pallate, ujesjellesa dhe gazsjellesa etj.

NENI 6

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte Shqiperise. Ajo mund te krijojë filial, dege e perfaqesi brenda e jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve ku do te ushtroje veprimtarine.

NENI 7

Akti i Themelimit do te jete efektiv nga dita e regjistrimit te kesaj Shoqerie ne Qendren Kombetare te Regjistrimit . Nga kjo dite Shoqeria fiton statusin e Personit Juridik te pavarur.

NENI 8

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete pa limit.

NENI 9

Kapitali themeltar (baze) i Shoqerise eshte 100,.000 lek (njqindmije) i perbere nga 1 kuote me vlere nominale nga 100,000 lek (njqindmije). Kapitali eshte kontribut i ortakut te vetem themelues te shoqerise, dhe zoterohet nga ortakët si me poshte:

1. Z. Alvin Shehu , i cili zoteron 1 (nje) kuote, me vlere 100,.000 lek (njqindmije) , ose 100 % te kapitalit.

Kapitali i Shoqerise mund te rritet sipas deshires se asamblese se pergjithshme dhe kushteve ne te cilat ushtron veprimtarine shoqeria.

NENI 10

Aktet dhe cdo dokument i Shoqerise hartohet dhe miratohet nga asambleja e pergjithshme e kesaj shoqerie.

ALL

NENI 11

Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte ti perdori ato ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj. Pas miratimit te bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor nga asambleja e pergjithshme e shoqerise , fitimi neto mund te perdoret lirisht me vendim te asamblese se pergjithshme te shoqerise.

NENI 12

Shoqeria mund te kriroje disa fonde : Fondin Themeltar, Fondin Rezerve ,Fondin e Shperblimit.Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te percaktoje edhe fonde te tjera.

NENI 13

Shoqeria do te celi llogari ne banke.Ajo do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar,ne EURO,USD e monedha te tjera te huaja.Veprimet bankare do te kryhen nga ana e administratorit te kesaj shoqerie Z.Bilbil Kruçi.

NENI 14

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Bilanci vjetor i shoqerise duhet te miratohet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

NENI 15

Per nevoja te veprimtarise se saj Shoqeria mund te beje punesimin e punonjesve duke lidhur kontrata te rregullta pune sipas legjislacionit te punes ne fuqi.

NENI 16

Administratori i Shoqerise do te jete Z. Alvin Shehu me nje afat 5 (pese) vjet, me te drejte riemerimi, detyrat dhe kompetencat e te cilit do te percaktohen ne Statut.

NENI 17

Asambleja e pergjithshme dhe personat qe do te punesohen ne shoqeri, jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, burimeve te mallrave, sherbimeve dhe njohurive e pervojes se fituar e shkembyer ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise,si dhe fshehtesine e gjendjes financiare te saj. Ata jane te detyruar te ruajne identitetin e shumave e te ardhurave te shoqerise, depozitave te saj dhe veprimtarine e shoqerise te pasqyruar ne bilancin vjetor. Ndaj atyre qe shkelin keto rregulla, asambleja e pergjithshme e shoqerise dhe administratori kane te drejte te marri masa ndeshkimore.

NENI 18

Shoqeria veprimtarine e saj e rregullon,pervecse me kete akt edhe me normat e percaktuara ne statut.

Akti i Themelimit u perpilua ne 5(pese) kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKET THEMELUES

(Alvin Shehu)

ALVIN SHEHU
All